

- Të zotërojnë njohje ndërdisiplinore për të programuar dhe realizuar strategji vepruese për menaxhimin e sistemit shëndetësor, dhe të një kompleksiteti të lartë për futjen në botën e punës në funksione të larta, si pranë firmave dhe organizatave private kombëtare dhe ndërkombëtare, si pranë administratave, enteve, organizatave dhe institucioneve publike kombëtare, ndërkombëtare dhe të Komunitetit Evropian.
- Të jenë të aftë për të përdorur në mënyrë të rrjedhshme, në formën e shkruar dhe të folur, përveç Shqipësisë, dhe dy gjuhë të huaja, Italishten dhe Anglishten, **sidomos përsa i përket termave profesionale.**

ART 2 – SEKTORËT E PUNËSIMIT

Per të diplomuarit në kursin Master të Nivelit të Dytë në Organizim dhe Drejtim të Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore mundësohen sektorët e punësimit dhe aktivitete profesionale në nivel drejtues në korporatat shëndetësore publike dhe private, në entet publike dhe private të interesuara në aktivitetet e programimit dhe kërkimit shkencor në fushën shëndetësore (spitale universitare, spitale, poliklinika, firma farmaceutike, institute sigurimi shëndetësor etj.), dhe në gjithë ato korporata industriale dhe shërbimesh që veprojnë në sektorin bio-mjekësor të zgjeruar, kombëtar dhe ndërkombëtar.

ART 3 - PRAKTIKË PROFESIONALE DHE STAZH

Për sa u tha më lart kurrikulat e kursit master të nivelit të dytë parashikojnë, në lidhje me objektivat e formimit profesional, aktivitete të jashtme si praktikë profesionale dhe stazhe formuese pranë firmave kombëtare dhe ndërkombëtare, enteve dhe administratave publike kombëtare dhe ndërkombëtare.

ART 4. KRITERET E PRANIMIT

Mund të marrin pjesë kandidatët të diplomuar pranë:

- a. Universiteteve publike shqiptare;
- b. Universiteteve private shqiptare, diploma në fjalë e të cilave është akredituar nga Ministria Shqiptare e Arsimit dhe Shkencës në momentin e lëshimit të saj;
- c. Universiteteve publike dhe private italjane të njohura nga MIUR;
- d. Universiteteve publike dhe private të vëndeve të Bashkimit Evropian, në rastin kur njihen nga qeveritë e tyre;
- e. Universiteteve publike dhe private të vëndeve të tjera nga BE dhe Shqipëria, pasi të jetë kontrolluar përputhshmëria e kurrikulave të studimit

Mund të marrin pjesë kandidatët në zotërim të një:

- a. Diplomë të integruar të nivelit të dytë ose Diplomë të sistemit të vjetër (kurs me një kohezgjatje minimumi katërvjeçare) në Mjekësi, Stomatologji, Farmaci;
- b. Diplomë të nivelit të dytë ose Diplomë të sistemit të vjetër (kurs me një kohezgjatje minimumi katërvjeçare) në Biologji, Inxhinjeri, Shkenca Ekonomike, Shkenca Juridike.

ART 5 – KRITERET E PJESMARRJES

Kërkesës për pjesmarrje në përzgjedhjen për pranimin në kursin Master të Nivelit të Dytë në Organizim dhe Drejtim i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, të drejtuar Rektorit, të plotësuar në modelin e posaçëm të shkarkueshëm në adresën internetit www.unizkm.al (moduli A) i duhen bashkangjitur dokumentet e mëposhtme:

- Fotokopje e noterizuar e çertifikatës së lauras/diplomës dhe çertifikatës së notave;
- Curriculum Vitae et Studiorum në italisht;
- Fotokopje të noterizuar të dokumentit të identitetit (pasaportë ose kartë identiteti)
- Tituj të tjerë të vlerësueshëm (kurse trajnimi ose specializime, kurse gjuhe, master, doktoratura) të noteriziara;
- Mandatin e arkëtimit të 3000 Lek jo të rimbursueshme, si kontribut për pjesmarrjen, që derdhen pranë receptionit të Universitetit Zoja e Keshillit të Mirë.

Kërkesa duhet të dorëzohet pranë Sekretarisë së Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Politike para orës 15:00 të ditës 15/12/2009. Kërkesat që do të dërgohen pas afatit të mësipërm nuk dotë pranohen.

Kërkesa dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur mbi të cilën shënohet emri dhe mbiemri i kandidatit dhe mbishkrimi “Master i Nivelit të Dytë në *Organizim dhe Drejtim i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore*“

Sekretaria do të lëshojë një deklaratë që vërteton dorëzimin e dokumentave ku do të shënohen data dhe ora.

ART 6. KRITERET E SELEKSIONIMIT

Numri i studentëve që do të pranohen do të jetë 25 (deri më 35 me vendim të Komitetit Shkencor)

Masteri nuk do të aktivizohet në rast se nuk do të arrihet numri minimal 18 i studentëve.

Vlerësimi i kandidaturave dhe seleksionimi i kandidatëve fitues do të bëhet nga një komision i posaçëm.

Kandidatët duhet të paraqiten në provën e seleksionimit me një dokument të vlefshëm identiteti (pasaportë ose kartë identiteti).

Seleksionimi do të bëhet në bazë të titujve dhe të një interviste profesionale-atitudinale në gjuhën italyane/angleze.

Rezultati përfundimtar do të jepet nga shuma e pikëve të marra (rezultati maksimal 70).

Kriteret e vlerësimit të titujve dhe provave të pranimit:

1. deri më 30 pikë për titujt e mëposhtëm:
 - a. nota e Laureas/diplomës deri më 20 pikë
 - b. diploma trajnimi ose specializimi, master, doktoratura deri më 10 pikë në bazë të kohëzgjatjes së kursit dhe të përputhshmërisë së planit didaktik;
2. deri më 20 pikë për Curriculum Vitae;
3. deri më 20 pikë për intervistën.

Për tu pranuar në Master kandidatët duhet të kalojnë një rezultat minimal që do të vendoset nga Komisioni gjykues para fillimit të intervistës dhe vlerësimit të titujve. Kandidatët që nuk kalojnë këtë rezultat nuk do të pranohen në master.

Intervista profesionale-atitudinale do të zhvillohet pranë Universitetit Zoja e Këshillit të Mirë, më datë 16 Dhjetor 2009 në orën 17:00 dhe më vonë sipas listës që do të afishohet pranë Sekretarisë së Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Politike.

Në rast rezultati të barabartë kalon përpara kush ka marrë rezultat më të lartë në intervistë. Do të pranohen në master ato që, në lidhje me numrin e vëndeve, do të jenë në pozicion të vlefshëm në renditje, e cila do të bëhet në bazë të rezultatit të përgjithshëm për çdo kandidat.

Renditja zyrtare do të afishohet më datë 18 Dhjetor 2009 pranë Sekretarisë së Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Politike.

ART 7. KRITERET E REGJISTRIMIT

Fituesit duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë së Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Politike, brënda dhe jo më vonë se më 6 Janar 2010:

- kërkesën e regjistrimit të plotësuar dhe të firmosur (moduli gjendet pranë Sekretarisë së Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Politike ose mund të shkarkohet nga adresa internet www.unizkm.al, moduli B);
- fotokopje e mandat pagesës prej € 3.500,00, që mund të paguhet sipas mënyrave të mëposhtme:
 - kësti i parë € 2.000,00 (deri tre ditë para fillimit të kursit)
 - kësti i dytë € 1.500,00 (brënda 30/04/2010)
 - me një pagesë të vetme € 3.500,00 (deri tre ditë para fillimit të kursit)
 - me anë të një pagese në bankë në emër të: Universiteti Zoja e Këshillit të Mirë. Moduli mund të tërhiqet pranë Zyrës së Financës të këtij Universiteti, nga e hëna në të premte, nga ora 9:00 deri 14:30.
- Laurea/diploma origjinale bashkë me çertifikatën origjinale të notave
- Një fotografi format dokumenti;
- Fotokopje e një dokumenti identiteti (pasaportë, kartë identiteti)
- Nuk do të pranohen kërkesa me dokumentacion jo të plotë.

Kandidatët fitues që duan të heqin dorë nga regjistrimi duhet t'ja komunikojnë me deklaratë të shkruajtur Sekretarisë së Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Politike

duke i bashkangjitur një fotokopje të një dokumenti identiteti (pasaportë, kartë identiteti), në mënyrë që të bëhet rishperndarja e vendeve.

Fotokopja e pagesave të kësteve të mëtejshme i duhen dorëzuar zyrës kompetente, në mungesë të këtyre nuk mund të kërkohen çertifikata, dhe nuk gëzohet e drejta për të mbrojtur titullin.

Sekretaria e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Politike nuk mban përgjegjësi për vonesa të mundshme në dorëzimin e dokumentave ose për dokumentacion jo të plotë.

Qytetarët në zotërim të një titulli lauree të ndryshëm nga ato të përmendura në thirrje, duhet të paraqesin aktin e njohjes nga ana e Ministrisë Shqiptare të Arsimit dhe Shkencës. Përndryshe vlerësimi do ti jepet për shqyrtim një Komisioni të posaçëm.

Kandidatët fitues që nuk do të përfundojnë regjistrimin brenda afatit të vendosur do të konsiderohen sikur kanë hequr dorë dhe vendet e tyre do ti zënë kandidatët vijues në listë sipas renditjes zyrtare: për këta afati i fundit i regjistrimit do të jetë data e fillimit të kursit.

Kuota e regjistrimit nuk mund të rimbursohet në asnjë mënyrë, përveç se në rast të mosaktivizimit të kursit Master.

Masteri do të fillojë më datë 11 Janar 2010.

ART 8. MËNYRA E ZHVILLIMIT

Leksionet do të zhvillohen pranë auditoreve të kampusit të Universitetit Zoja e Këshillit të Mirë, Rruga e Durrësit, në Tiranë. Orari do të jetë 17:00 - 21:00 nga e hëna në të premte, dhe 9:00 – 13:00, 15:00 – 19:00 të shtunën.

Pjesmarrja është e detyrueshme. Për pranimin në provimin përfundimtar, për çdo disiplinë studenti duhet të marri pjesë në të paktën 60% të aktiviteteve në auditor. Leksionet do të zhvillohen në gjuhën italyane dhe shqiptare.

